



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr 27302 prot

Elbasan, më 27.11.2025

VENDIM
Nr 65, datë 27.11.2025

Për

trajtim me burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2024-2025, të studentëve, që vazhdojnë studimet në program të parë studimi në; programet e studimit me karakter profesional, programet studimit bachelor, programet e integruara të studimit.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", i ndryshuar, VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimi në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", i ndryshuar, VBA nr 60 datë 31.12.2024 "Për trajtim me burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2024-2025, të studentëve, që vazhdojnë studimet në program të parë studimi, në programet e studimit me karakter profesional, programet studimit bachelor, programet e integruara të studimit", të ndryshuar, Relacionit datë 27.11.2025 "Për trajtim me burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2024-2025, të studentëve, që vazhdojnë studimet në program të parë studimi në; programet e studimit me karakter profesional, programet studimit bachelor, programet e integruara të studimit", paraqitur nga Administratori z. Eljan Hoxha, Bordi i Administrimit.

VENDOSI:

- 1- Përfiton bursë financiare 1 studentë me kriterë të tjera dhe përfitojnë përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit 4 studentë me kriterë tjera.
- 2- Nuk përfiton bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa e shkollimit një student, sipas listës bashkëlidhur.
- 3- Vendimarrja të zbatohet pas konfirmimit të statusit të studentëve.
- 4- Ngarkohet Administratori i Universitetit me zbatimin e këtij vendimi
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT
Dr. Ardian Durrmish

